



Valbona Gaxha

Sekretar i Përgjithshëm KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Znj. Valbona Gaxha është diplomuar në Universitetin e Tiranës, në degën Administrim Biznesi. Ajo ka ndjekur më tej studimet pasuniversitare në nivel master në “Ekonomi të Zbatuar” pranë Institutit për Studime të Avancuara në Vjenë, Austri (1995). Në vitin 2008, është diplomuar në Master Shkencor në “Kontabilitet dhe Auditim” pranë Universitetit të Tiranës.

Znj. Gaxha është e certifikuar si Kontabiliste Publike nga Instituti i Kontabilistëve të Certifikuar Publik (CPA) në Ontario, Kanada (2016), si dhe si Audituese Ligjore nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) në vitin 2018.


Ajo është pjesë e stafit të Kontrollit të Lartë të Shtetit që prej vitit 2018, fillimisht në pozicionin e Kryeauditueses në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit, më pas si Drejtoreshë e këtij departamenti, ndërsa prej vitit 2021 e në vazhdim, mban funksionin e Sekretares së Përgjithshme të KLSH-së.


Znj. Gaxha ka mbajtur pozicione drejtuese si në sektorin privat, ashtu edhe në administratën publike shqiptare, duke përfshirë institucione si: Autoriteti i Konkurrencës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Raiffeisen Leasing sh.a. dhe Landeslease sh.a. Ajo zotëron gjithashtu mbi 10 vite përvojë profesionale në fushën e kontabilitetit dhe financës në Toronto, Kanada, ku ka punuar pranë disa kompanive private, përfshirë sektorin financiar.


Gjatë karrierës së saj, Znj. Gaxha ka qenë pjesë e trupës pedagogjike të Fakultetit Ekonomik, si asistente pedagoge në Departamentin e Kontabilitetit, dhe ka marrë pjesë në një sërë konferencash profesionale në fushat e financës dhe auditimit.

Aktualisht, ajo është trajnuese në programin për Auditin e Brendshëm pranë Ministrisë së Financave, si dhe tutore/trajnere lokale në programin e certifikimit të avancuar për Auditin e Brendshëm, në bashkëpunim me CEF.

Kontakt

 vgaxha@klsh.org.al

 Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë
Shqipëri

 www.klsh.org.al